



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit anonim për korrupsion, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 11.12.2020, morri

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-3475 nga viti 2019, formuar pas denoncimit 12-3475/1 me datë 08.07.2019 dorëzuar nga parashtrues i panjohur, **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën 12-3475 nga viti 2019, në rastin e lëndës nuk janë vërtetuara akuzat e lëndës.

Lënda me numër 12-3475 nga viti 2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të depersonalizuar të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-3457 nga viti 2019 është formuar pas lajmërimit/denoncimit me numër 12-3457/1 me datë 08.07.2019, dorëzuar deri te Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtrues i panjohur – denoncim anonim.

Në denoncim janë treguar akuza për procedurë joligjore në zgjedhje të drejtorëve në tre Ndërmarrje publike, dhe atë NP Higjiena komunale, NP për menaxhim me objektet sportive – Jasmin dhe Muzeu lokal i galerisë, të realizuara pas konkursit publik shpallur nga Komuna me datë 18.05.2018.

Gjatë rishikimi të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasysh akuzat nga parashtruesi dhe në drejtim të caktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri te Komuna për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve në lidhje me rastin e lëndës. Me kërkesë të KSHPK është dorëzuar lajmërimi i kërkuar dhe pas kontrollimi të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës nga ana e KSHPK është vërtetuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për procedurë për zgjedhje të drejtorëve në ndërmarrjet publike të realizuara nëpërmjet konkursit publik të shpallur nga Komuna me datë 18.05.2018 dhe në të cilën zgjedhja e kandidatëve është bërë me datë 20.06.2018, me çka, sipas akuzave në denoncim, janë zgjedhur kandidatët të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara, gjegjësisht, kandidatë e zgjedhur nuk posedojnë certifikatë adekuat për njohje e gjuhës së huaj – gjuhës angleze dhe të njëjtin ato nuk e dorëzuan në afatin e paraparë prej një viti, deri në 20.06.2019, ose dorëzuan, por certifikatë fiktive dhe të pavlerë të cilët përputhen me certifikatet e kërkuar me shpalljen në përputhje me Ligjin për ndërmarrje publike, që don të thotë se nga kjo ditë ato në mënyrë joligjore e kryejnë funksionin e drejtorit.
- Nga kontrollimi i bërë i dispozitave ligjore, është konstatuar se për zgjedhje të drejtorit në ndërmarrje publike lokale konkurs shpallë Kryeprefekti i Komunës, në rastin Kryeprefekti i

komunës, kurse konkursi shpallet në përputhje me nenin 23 paragrafi 4 nga Ligji për ndërmarrje publike dhe në të njëjtin theksohen kushtet e parapara të cilat personat duhet t'i plotësojnë që të mund të zgjedhet për kandidat të volitshëm dhe të emërohet për drejtor të një ndërmarrje publike, kurse vendimi për zgjedhje për konkursin e shpallur për zgjedhje të drejtorëve në ndërmarrjet publike, e merr Kryeprefekti i Komunës.

- Me datë 28.05.2020, me kërkesë të KSHPK është marrë përgjigje nga Komuna me shtojcë për dëshmi të dokumentacionit, i cili informohet se:
 - o Në procedurën për zgjedhje të drejtorit në NP Higjiena komunale, është marrë vendim për zgjedhje të drejtorit nr...../..... me datë 04.06.2019, kurse nga ana e kandidatit të zgjedhur është dorëzuar certifikatë i pranuar ndërkombëtar për njohje aktive të gjuhës angleze – Aptis, niveli B2 – në përputhje me Ligjin për ndërmarrje publike me datë 09.03.2018.
 - o Në procedurën për zgjedhje të drejtorit në NP për menaxhim m objektet sportive është marrë vendim për zgjedhje të drejtorit nr./..... me datë 04.06.2018, nga ana e personit të zgjedhur është dorëzuar certifikatë për gjuhë të huaj nr./..... me datë 19.06.2019, certifikatë i pranun ndërkombëtar i nostrifikuar në noter nr. AOP 19.05.2019 C1, për njohje aktive të gjuhës angleze TEOFEL IBT – në përputhje me Ligjin për ndërmarrje publike.
 - o Në procedurën për zgjedhje të drejtorit në Muzeun lokal të galerisë, është marrë vendim për zgjedhje të drejtorit nr.09-2680/1 me datë 11.06.2018 dhe është dorëzuar certifikatë për gjuhë të huaj nr./..... me datë 19.06.2019 – certifiakt i pranuar ndërkombëtar nostrifikuar në noter AOP 19.06.2019 C1 për njohje aktive të gjuhës angleze – TEOFEL IBT – në përputhje me Ligjin për kulturë.

Në ndërkohë, Komuna lajmëron se në procedurën për zgjedhje të drejtorëve në institucionet e përmendura mësipër, nga ana drejtorit të zgjedhur në NP, certifikatë të pranuar ndërkombëtar për njohje aktive të gjuhës angleze është dorëzuar me dorëzimin e dokumentacionit të plotë në afatin e caktuar për dorzim të dokumnetave pas konkursit të shpallur publik. Në procedurë për zgjedhje të Drejtorit në NP për menaxhim me objektet sportive dhe Drejtor për Muzeun lokal të galerisë certifikatet e pranuar ndërkombëtare për njohje aktive të gjuhës angleze janë dorëzuar në afat prej një viti pas emërimit, në përputhje me nenin 13 nga Ligji për dryshime dhe plotësime të Ligjit për ndërmarrje publike (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 11/2018) dhe Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për kulturë (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 11/2018)

”Drejtori i cili është emëruar në periudhën prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në 01.Shtator 2018 është i obliguar ta plotëson kushtin për njohje të gjuhës angleze më së voni në periudhë prej një viti nga dita e emërimit. Drejtori i cili nuk e plotëson kushtin për njohje të gjuhës angleze në periudhë prej një viti nga paragrafi 1 i këtij neni i ndërpritet mandati”.

Në bazë të caktimit të gjendje faktike në rastin e lëndës nuk është konstatuar thyerje të ligjit, gjegjësisht KSHPK konstatoi se në procedurën e lëndës për zgjedhje të drejtorëve në tre ndërmarrjet publike të përmendura, nga ana e Komunës është vepruar në përputhje me rregullativën ekzistuese në shtet dhe me respektimin e dispozitave ligjore në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit pas konkursit publik dhe plotësimit të kushteve të nevojshme për të njëjtin, që don të thotë se në rastin e lëndës nuk janë vërtetuar akuzat e lëndës. Duke pasë

parasyshtë të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për procedurën e lëndës, procedura për lëndën ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasyshtë të theksuarën më sipër, komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Është vendosur me datë 11 Dhjetor 2020 me numër 12-1981/3

Dorëzuar deri: te Arkivi
Pas përfundimit të KSHPK
Punoi: J. C., këshilltarë
Miratoi: m-r SH. S., anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ
Kyetar: Biljana Ivanovska

